



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Nr. 635/9 Prot.

Vlorë më, 11.02 2025

VENDIM

Nr. 12, datë 10.02.2025

**PËR
MIRATIMIN E KRIJIMIT TË GRUPEVE MËSIMORE DHE GRUPEVE TË
PËRHËRSHME OSE TË PËRKOHSHME ME KARAKTER KËRKIMOR-
SHKENCOR TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Në mbështetje nenit 3 pika 4, nenit 25, 38 të Ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 10, pika 2, nenit 19, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit Nr. 27, datë, 29.12.2017 "*Për strukturat e brendshme akademike dhe adminmistrative*" si dhe referuar shkresës së MAS NR. 8103/1, prot, datë, 24.01.2025, kërkesës së Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë ardhur me shkresën nr.616 prot, datë.07.02.2025, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 10.02.2025

VENDOSI:

1. Të miratojë praktikën e ndjekur deri më tani nga Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, sipas Udhëzimit Nr. 27, pika 8 datë, 29.12.2017 "*Për strukturat e brendshme akademike dhe adminmistrative*" si më poshtë vijon:
 - a) Njësitë Bazë mund të organizohen në grupe mësimore dhe në grupe të përhershme ose të përkohshme kërkimore-shkencore të cilat përbëhen nga jo më pak se 5 (pesë) anëtarë personel akademik me kohë të plotë
 - b) Njësitë bazë që kanë më pak se 10 anëtarë personel akademik me kohë të plotë në përbërjen e tyre mund të krijojnë një grup mësimor/ grup kërkimor-shkencor.
 - c) Njësitë Bazë që kanë 10 apo më tepër anëtarë personel akademik me kohë të plotë mund të organizohen në dy apo më tepër grupe mësimore /grupe të përhershme ose të përkohëshme me karakter kërkimor-shkencor.
2. Një kopje e këtij vendimi i bëhet me dije njësisë Kryesore dhe Njësisë Bazë në UV.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliqaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORI

Nr. 616 Prot.

Vlorë më, 07.07.2025

Lënda: Kërkesë për miratim në parim të krijimit të grupeve mësimore dhe grupeve të përhershme ose të përkohshme me karakter kërkimor- shkencor.

SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE

KËTU

Referuar kërkesave të ardhura nga ana e Drejtuesve të Njësive Kryesore në UV në lidhje me riorganizimin e strukturës dhe grupeve mësimore dhe grupeve të përhershme ose të përkohshme me karakter kërkimor- shkencor Rektori i UV-së i është drejtuar me shkresën nr. 3076 prot, datë 23.12.2024 "Kërkesë për interpretim" Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në të cilën ka kërkuar qëndrimin e MAS në lidhje me krijimin e grupeve mësimore dhe grupeve të përhershme ose të përkohshme me karakter kërkimor- shkencor.

Me shkresën nr.8103/1 prot, datë 24.01.2025 "Kthim përgjigje" MAS referon nenin 3, pika 4 të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" *"Autonomia organizative dhe e përzgjedhjes së personelit garantohet nëpërmjet së drejtës: a) për t'u vetëqeverisur, për të zgjedhur organizmat drejtues, për të organizuar strukturat dhe rregulluar mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë së tyre nëpërmjet akteve të tyre të brendshme, të hartuara në përputhje me këtë ligj dhe me aktet e tjera, ligjore e nënligjore, në fuqi;"*

Në këtë kontekst duke qenë se është një vendimarrje e brendshme mënyra se si Universiteti i organizon grupet mësimore dhe grupet e përhershme ose të përkohshme me karakter kërkimor-shkencor, e cila është e drejtë ekskluzive e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit sipas përcaktimeve të neneve 38 dhe 49 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe duke parë kërkesat dhe nevojat që kanë njësitë bazë për zhvillimin e veprimtarive mësimore dhe përmirësimin e procesit arsimor, sugjerojmë të procedohet me ngritjen e grupeve mësimore dhe kërkimore shkencore sipas praktikës së deritanishme ku Njësitë Bazë kanë përcjellë propozimet për ngritjen e grupeve mësimore dhe kanë këto struktura akademike në nivel njësie bazë. Për ato njësi bazë që kanë më pak se 10 anëtarë personel akademik në përbërjen e tyre të mund të krijohet një grup mësimor dhe për njësi bazë të cilat kanë 10 apo më tepër anëtarë personel akademik të mund të organizohen në dy apo më tepër grupe mësimore apo grupe të



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORI

përhershme ose të përkohshme me karakter kërkimor- shkencor në respektim të pikës 8 të Udhëzimit 27, datë 29.12.2017.

Ngritja e grupeve mësimore duhet të jenë në përputhje me rregullat dhe procedurat përkatëse, në përputhje me rregulloret e brendshme dhe ato ligjore duke patur parasysh pikën 5 dhe 11 të nenit 25 të Ligjit për Arsimin e Lartë 5. *Departamenti mund të organizohet në grupe mësimore dhe në grupe të përhershme ose të përkohshme me karakter kërkimor-shkencor, në përputhje me llojin dhe misionin e institucionit. 11. Rregulla të tjera për strukturën dhe funksionimin e departamentit përcaktohen në statutin dhe rregulloret e institucionit të arsimit të lartë, si dhe pikës 8 të Udhëzimit nr.27, datë 29.12.2017 "Për strukturate brendshme akademike" Strukturat akademike në nivel njësie bazë të konsiderohen: a) Drejtuesi i departamentit; b) Grupet mësimore/kërkimore shkencore që përbëhen nga jo më pak se 5 personel akademik me kohë të plotë.*

Sa më sipër propozoj miratimin në mbledhjen me të afërt të Senatit Akademik krijimin e grupeve mësimore dhe grupeve të përhershme ose të përkohshme me karakter kërkimor-shkencor.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin ,

REKTORI

Prof. Dr. Aurela SALIAJ

